



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA



BURGU I IDEALIT

MUZEU I BURGUT TË PRISHTINËS

Historiku i ish Burgut të Qarkut në Prishtinë - Qendra e Paraburgimit në Prishtinë

Ndërtesa e Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë (ish Burgu i Qarkut në Prishtinë) ka filluar të ndërtohet në fillim të viteve 50-ta, ndërsa ka përfunduar në vitin 1955. Në atë kohë Burgu i Qarkut në Prishtinë ka qenë nën ombrellën e Sekretariatit të Punëve të Brendshme. Në fund të viteve të '70 është bërë ndarja e institucioneve dhe burgjet kanë kaluar nën kompetencën e Sekretariatit të Judikaturës.

Në atë kohë Burgu i Qarkut në Prishtinë ka pasur një kapacitet prej 150 deri 200 të burgosur, pa kushte elementare (pa tualete e banjë brenda në dhoma). Ky institucion i asaj kohe ka pasur lidhshmërinë me objektet përcjellëse të Sekretariatit të Punëve të Brendshme respektivisht Sigurimin Shtetëror të asaj kohe, nga i cili sigurim janë marr në pyetje gjithë veprimtarët e çështjes kombëtare që kanë qenë të arrestuar.

Gjatë tërë këviteve të '80 dhe '90 në Burgun e Qarkut në Prishtinë, dhe jo vetëm aty, janë maltretuar dhe torturuar në mënyrë sistematike të burgosurit Shqiptar e veçanërisht pas hyrjes së masave të dhunshme të pushtetit të asaj kohe kur edhe janë dëbuar nga puna stafi shqiptar duke i zëvendësuar me staf serb dhe të kombësive tjera pakicë të cilët kanë shtuar keqtrajtimi dhe maltretimi i të burgosurve Shqiptar sidomos atyre Politikë.

Pas përfundimit të luftës, Qendra e Paraburgimit Prishtinë ishte nën administrimin e KFOR-it Anglez. Në nëntor të vitit 1999, QP e Prishtinës kalon nën administrimin e UNMIK-ut. Ndërsa nga muaji Shkurt i vitit 2005, kompetencat për administrimin e QP të Prishtinës i janë transferuar tërësisht stafit vendor. Fillimisht, Qendra e Vjetër e Paraburgimit në Prishtinë, ndodhej në Qendër të qytetit, në kompleksin e ndërtesave në mes të Gjykatës Supreme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, dhe kishte një kapacitet prej 66 shtretërve dhe ofronte kushte jashtëzakonisht të dobëta banimi për të burgosurit dhe për stafin. Si pasojë e këtyre kushteve, Qendra e Paraburgimit Prishtinë mbyllet në fund të vitit 2015.

Ky institucion sipas informatave është rinovuar në vitet 1994 – 1995 kur nga 26 dhoma janë shndërruar në 17 sish duke iu krijuar kushte elementare sanitare (banjo) brenda dhomave. Poashtu është rinovuar edhe në vitet 2000 – 2001 me instalimin e administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë UNMIK, ku janë vendosur barriera e grila dhe prioritet i vetëm ka qenë siguria me ç'rast por jo edhe respektimi i drejtave të njeriut në burgje të garantuara me konventa ndërkombëtare.

Rreth viteve 2006 - 2007 për herë të parë janë lejuar anëtarët e KMDLNJ-së për të vizituar në mënyrë të vazhdueshme të burgosurit si dhe hapësirat ku mbaheshin të ndaluarit.

Monitorimi i organizatave për të drejtat e njeriut gjithmonë ka dhënë efekte pozitive si në përmirësimin e kushteve ashtu edhe në trajtimin sa më dinjitoz të të burgosurve. Pas mbylljes së burgut të Prishtinës në fund të vitit 2015, të burgosurit dhe personeli kanë kaluar në ndërtesën e burgut të sigurisë së lartë, ndërsa nga Janari i vitit 2019 kanë kaluar në ndërtesën e re të burgut në fshatin Hajvali-Prishtinë në afërsi të Pallatit të Drejtësisë.

Background of the Former-District Prison in Prishtina – Detention Centre in Prishtina

Construction works at the building of the Detention Centre in Prishtina (Former-District Prison in Prishtina) started in early 1950s, and were completed in 1955. At the time, the District Prison in Prishtina was under the Secretariat of Internal Affairs. By the late 1970s, the institutions were separated and the prisons were transferred to the competency of the Secretariat of the Judiciary.

At the time, the District Prison in Prishtina had a capacity of 150 to 200 prisoners, without the basic conditions (with no toilets and bathrooms in the rooms). This institution of the time was related to the monitoring facilities of the Secretariat of Internal Affairs, namely the State Security of that time, which interrogated all activists of the national cause who were under arrest.

Throughout the 1980s and 1990s, Albanian prisoners were systematically abused and tortured in the District Prison in Prishtina, but not only, and particularly after violent measures of the regime of that time were imposed, when the Albanian staff was dismissed by force and replaced by Serbian and other ethnic monitories staff, thus amplifying the abuse and torture of Albanian prisoners, especially the political ones.

After the war, the Detention Centre in Prishtina was under the British KFOR administration. In November 1999, the DC in Prishtina was transferred to the UNMIK administration, while in February 2005, the administration competencies of the DC in Prishtina were completely transferred to the local staff. Initially, the Old Detention Centre in Prishtina was located in the city centre, in the building complex between the Supreme Court and the General Police Directorate, with a capacity of 66 beds, and extremely poor living conditions for the prisoners and the staff. As a result of these conditions, the Detention Centre in Prishtina was closed by the end of 2015.

According to the information, the institution was renovated in 1994-1995, when the number of rooms was reduced from 26 to 17, to create basic sanitary conditions (bathrooms) within the rooms. It was also renovated in 2000-2001, with the establishment of the United Nations administration in Kosovo, UNMIK, when barriers and bars were installed and security was the only priority, but not also the respect for human rights in prisons granted by international conventions.

Around 2006-2007, the members of the CDHRF were for the first time allowed to continuously visit the prisoners and the premises where the detained were held.

The monitoring conducted by human rights organizations always produced positive effects both in terms of improved conditions as well as in the fair treatment of prisoners. When the prison of Prishtina was closed by the end of 2015, the prisoners and the staff were transferred to the high security prison, while in January 2019 they were transferred to the new prison in Hajvali, Prishtina, close to the Palace of Justice.

Istorijat bivšeg Okružnog zatvora u Prištini - Pritvorski centar u Prištini

Zgrada Pritvorskog centra u Prištini (bivši Okružni zatvor u Prištini) počela je da se gradi početkom 50-ih godina, dok završena je 1955. godine. U to vreme Okružni zatvor u Prištini je bio pod okriljem Sekretarijata unutrašnjih poslova. Krajem '70 godina urađena je podela institucija i zatvori su prešli pod nadležnost Sekretarijata za pravosuđe.

U to vreme Okružni zatvor u Prištini je imao kapacitet od 150 do 200 zatvorenika, bez osnovnih uslova (bez toaleta i kupatila u unutrašnjosti soba). Ova institucija tog vremena imala je vezu sa pratećim objektima Sekretarijata unutrašnjih poslova, odnosno Državnu bezbednost tog vremena, iz kojeg obezbeđenja su saslušavani svi aktivisti nacionalnog pitanja koji su bili uhapšeni.

Tokom svih '80 i '90 godina u Okružnom zatvoru u Prištini, i ne samo tu, su sistematski zlostavljani i mučeni albanski zatvorenici a posebno nakon uvođenja nasilnih mera vlastitog vremena kada su i izbačeni sa posla albansko osoblje zamenivši ih srpskim osobljem i drugim manjinskim zajednicama koji su povećali zlostavljanje i maltretiranje albanskih zatvorenika, posebno onih političkih.

Nakon završetka rata, Pritvorski centar u Prištini je bio pod administracijom engleskog KFOR-a. U novembru 1999. godine, PC Prištine prelazi pod administracijom UNMIK-a. Dok su od februara 2005. godine nadležnosti za administraciju PC Prištine u potpunosti prenete lokalnom osoblju. Prvenstveno, Stari pritvorski centar u Prištini se nalazio u centru grada, u kompleksu zgrada između Vrhovnog suda i Opšte direkcije policije, i imao je kapacitet od 66 kreveta i pružao izuzetno slabe uslove smeštaja za zatvorenike i osoblje. Kao posledica ovih uslova, Pritvorski centar u Prištini se zatvara krajem 2015. godine.

Prema informacijama, ova institucija je renovirana 1994 - 1995. godine kada je od 26 soba pretvoreno u 17 njih, stvarajući osnovne sanitarne uslove (kupatila) unutar soba. Takođe je renoviran i 2000 - 2001. godine ugradnjom administracije Ujedinjenih nacija na Kosovu UNMIK, gde su postavljene barijere i ćelije, i jedini prioritet je bila bezbednost u kom slučaju, ali ne i poštovanje ljudskih prava u zatvorima zagarantovanim međunarodnim konvencijama.

Oko 2006 - 2007. godine, po prvi put je dozvoljeno članovima SZLJPS-a da na kontinuiran način posećuju zatvorenike, kao i prostorije gde su držani pritvorenici.

Nadzor organizacija za ljudska prava je uvek davao pozitivne efekte kako u poboljšanju uslova tako i u najdostojanstvenijem tretmanu zatvorenika. Nakon zatvaranja Zatvora u Prištini krajem 2015. godine, zatvorenici i osoblje su prešli u zgradu zatvora visoke bezbednosti, dok od januara 2019. godine prešli su u novu zgradu zatvora u selu Ajvalija-Priština u blizini Palate pravde.

